



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Datë .11 .2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Dekor”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- **Mjete dekorative 44812400-9**
- **Dekorime 45451000-3**

VLERA E FONDIT LIMIT QË PROKUROHET: 4,018,000 (katër milion e tetëmbëdhjetë mijë) lekë PA TVSH.

Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike që operojnë në treg dhe duke përlogaritur vlerën mesatare të tyre në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi i parë pikë b) të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pikë 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pikë 2/c dhe nenit 78, pikë 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës të parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogel se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Termat e referencës, sasi, specifikimet teknike janë hartuar nga personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin Nr. 400 Prot., datë 04.11.2025.

Ato janë si më poshtë:

Nr	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia
1	Element dekorativ në formë dreri 3 dimensional. Lartësi maksimale 170cm me forma të ndryshme sipas kërkesës të autoritetit kontraktor, materiali i konstruksionit Alumin, i veshur me drita dekorative ngjyrë e bardhë e ngrohtë 3000-4000K.	copë	10
2	Instalacion Dekorativ Metalik në formë TULIPANI, i ndërtuar me profile hekuri i veshur me drita dekorative dhe fotosulinë.	copë	46

3	Instalacion Metalik ne forme 6 (gjashtë) i ndertuar me profile hekuri.Struktura e veshur me shirita dekorative LED,me mundesi bashkimi me mufta hermetike.	copë	1
---	--	------	---

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Element dekorativ ne forme Dreri,

- 3 dimensional.
- Lartesi maksimale 270cm nga Toka tek briret, trupi lartesi maksimale nga toka 140cm dhe gjatesia e trupit 170cm
- Dreret do te jene ne forma te ndryshme, dimensionet variojne nga 270cm x 170cm deri ne 140 cm x 120cm. Modelet sipas fotove ilustruese **Modeli 1.1**
- Materiali i konstruksionit Alumin
- I veshur me drita dekorative ngjyre e bardhe e ngrohte 3000-4000K.
- Ngjyra e kabllit transparente ose e bardhe

Modeli 1.1



2. Instalacion Dekorativ Metalik ne forme tulipani Modeli 2.2

- I ndertuar me profile hekuri tubolare te dimensioneve: Baza Ø60cm, ndertuar me profil hekuri 30x30x1.5mm. Trupi i Tulipanit, perbere nga 8 elemente me gjatesi 310cm te harkuar, ndertuar me profil hekuri 20x20x1.5mm, Baza e tulipanit, Ø40cm, ku fillojne petalet, ndertuar me profil 20x20x1.5mm. Petalet e tulipanit, 6 cope, ndertuar me profil hekuri 12x12x1mm.
- Lartesia e Trupit te tulipanit 300 cm, Lartesia e Petaleve te tulipanit 120cm, Diametri ne pjesen fundore te petaleve Ø130cm, Lartesia e gjithe strukture 420cm
- Dimesionet e petaleve 130x50cm
- Profili i perdorur ne baze 30x30x1.5 cm
- Profili i perdorur ne trup 20x20x1.5 cm
- Profili i perdorur ne kupole 12x12x1.0 cm
- Struktura e lyer me antiruxho dhe boje vaji gri
- Struktura duhet te jete e perbere nga dy pjese simetrike vertikale me mundesi bashkimi me njera tjetren me vida per tu montuar qe te krijojne strukturen e perfunduar. Ne bazen fundore Ø60cm dhe ne bazen e tulipanit Ø40cm duhet te kete nje strukture te dyte metalike, lame 40x5mm ne forme qafore, me vida, per kapjen e gjithe strukture ne shtyllat e ndricimit me dimension Ø130mm
- Struktura te jete e veshur me drita dekorative LED, me ndricim statik:
 - Ngjyra e ndricuesve 3000 - 4000K.
 - Ngjyra e kabllit e gjelber.
 - Verifikimi i cilesise CE-GS, CE-GS TUV, RoHS
 - Gjatesia e 1 njesie 38 meter se bashku me transformator, gjatesia e kabllit me llampa LED 35 meter.
 - Nr i llampave LED me kapuc mbrojtjes 700 cope/njesi.
 - Distanca midis llampave cdo 5 cm.
 - Mundesia e bashkimit me mufta hermetike per zgjatjen e me shume se nje njesie.
 - Ryma elektirke 220-240V AC / 31V DC, me transformator.
 - Secila llampe 3V / 20mA / 0.06W / 3mm
 - Certifikimi per perdorim te jashtem IP44
- **Veshje me Fotosuline LED me dy ngjyra 4000K dhe 6400K per kupolen me petale**
 - Trashesia e tubit 13mm
 - Largesia midis llampave 2.77cm
 - Tubi te kete tre fije teli brenda qe lidh llampat
 - Mundesia e prerjes te tubit, cdo 1 meter
 - Mbrojtja nga uji IP65
 - Mbrojtje UV
 - Ryma elektrike 230V AC, Fuqia e ndricimit 4.3W/m
 - Llampat 3V / 20mA / 0.06W , Dimensioni i llampave LED: 3mm

Modeli 2.2



3. Instalacion Metalik ne forme 6 (gjashtë) i ndertuar me profile hekuri

- Profil hekuri i perdorur 25 x 25 x 2 mm
- I lyer me antiruxho dhe boje. Ngjyra e zeze
- Struktura tredimensionale me tre ndarje terthore
- Dimensione: Lartesi 4 meter, gjeresi 3 meter dhe thellesi 1 meter
- Struktura e veshur me shirita dekorative LED, me mundesi bashkimi me mufta hermetike.

Largesia e shiritave nga njeri tjetri cdo 7cm. Ngjyra e ndricuesve 3000 - 4000K.

Ngjyra e kabllit e gjelber. Standarti IP44. Distanca midis llampave cdo 5 cm.

Furnizim elektrik 220-240V AC / 31V DC me transformator. Ndricim static

- Perimetri i strukture i veshur me ndricim fotosuline dekorative 4000K. Trashesia e tubit 13mm. Largesia midis llampave 2.7 cm. Tubi te kete tre fije teli brenda qe lidh llampat.

Mundesia e prerjes te tubit, cdo 1 meter. Mbrojtja nga uji IP65. Furnizim elektrik 230V AC, Fuqia 4.3 W/m. Mbrojtje UV.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Kontraktuesi duhet të furnizojë me mallra në përputhje me standartet e kërkuara dhe specifikimet teknike me shpenzimet e tij deri në dorëzimin në vendin e përcaktuar që është magazina e Ndermarrjes së Shërbimeve publike, Bashkia Korçe.

Operatorët ekonomike janë të detyruar të paraqesin në ofertat e tyre mallrat e kërkuara sipas standartit të kërkuar si mësipër.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Afatet e ekzekutimit: **15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës**

Nr.	Përshkrimi i mallit	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Element dekorativ në formë dreri 3 dimensional. Lartësi maksimale 170cm me forma të ndryshme sipas kërkesës të autoritetit kontraktor, materiali i konstruksionit Alumin, i veshur me drita dekorative ngjyrë e bardhë e ngrohtë 3000-4000K.	10 copë	Në magazinën e NSHP-së	15 ditë
2	Instalacion Dekorativ Metalik në formë TULIPANI, i ndërtuar me profile hekuri i veshur me drita dekorative dhe fotosulinë.	46 copë	Në magazinën e NSHP-së	15 ditë
3	Instalacion Metalik në formë 6 (gjashtë) i ndërtuar me profile hekuri. Struktura e veshur me shirita dekorative LED, me mundësi bashkimi me mufta hermetike.	1 copë	Në magazinën e NSHP-së	15 ditë

NJËSIA E PROKURIMIT